



STUDIM - PROJEKTIM REHABILITIMI I SHETITORES TAULANTIA



STUDIM - PROJEKTIM REHABILITIMI I SHETITORES TAULANTIA

RELACIONI PËRSHKRUES

Qershor 2018

Grupi I Projektimit:

Inxh. Ndertimi Gezim Islami

Ark. Elton Çarçani

Inxh. Topograf Kujtim Canameti

Inxh. Gjelog Leonard Kazanxhiu

Inxh. Elektrik Hajdar Kurti


Ark.Barbara Agnoletto

Ark. Francesco Spanò

VIJA E RE BREGDETARE E QYTETIT TE DURRESIT

Projekti per rehabilitimin e shetitores Taulantia te qytetit te Duresit ndertohet duke u bazuar mbi tre objektiva kryesore:

1. Ripercaktimi i raportit te kesaj zone me zonat urbane prane saj, me qendren dhe me elementet e rendesishem historike, si objektiv kryesor per te shtuar dhe pasuruar sistemin e hapësirave publike;
2. Ripercaktimi i raportit te qytetit me detin;
3. Realizimi i nje parku te vertete per ti ofruar qytetit me shume hapësira publike per qytetaret, sheshe, hapësira te gjelberuara, te ndricuara dhe parqe per aktivitete sportive dhe lojra per femije.




Ne kushtet aktuale kjo zone po perjeton nje lloj pezullimi, ne pritje te nje ideje precize.

Hapësira e gjelbert prezantohet si nje grup copezash dhe lulesh te vogla, shetitorja prane detit shfaqet si nje hapësire e shtruar pa nje raport te vertete me ujin ; ne mbremje kjo zone eshte e ndricur pak dhe ne menyre jo homogjene.

Nderhryrjet qe po zhvillohen ne rrugen Taulantia kane filluar nje projekt per rikualifikimin e saj i cili duhet te jete i perfunduar dhe preciz: ne kete moment marredheniet me qendren nuk jane te lehta dhe te percaktuara qarte.

Edhe nje hapësire e re eshte e disponueshme ne lindje, prane portit. Kjo hapësire perfaqeson nje mundesi per te gjithë qendren dhe duhet te perdoret ne menyre adekuate, duke u bere pjese e shetitores pergjate detit.

Nje raport i ri me qytetin




Projekti strukturohet duke rimarre permasat dhe duke krijuar lidhje te forta me qendren dhe me hapësiren urbane se ciles i referohet. Rruget qe vijne nga qyteti hyjne ne parqe, krijojne konfiguracione dhe lidhen me vijen bregdetare duke krijuar mundesi per lokalizimin e pikave te rendesishme, sic jane sheshet e krijuara ne det.

“Sheshi mol”

Hapësira kryesore terthore , nje shesh i bardhe i mbjellur me peme ne te gjithe gjatesine e tij , rikthen lidhjet me zonen ku ndodhet Torra Veneciane dhe me portin e ri turistik duke u zgjatur me pas ne det. Kjo hapësire e madhe , e ngritur rreth 35-45 cm me lart kundrejt parkut , e shtruar me gure te bardhe, pershkoi ne menyre te tertthorte te gjithe parkun duke u bere vizualisht nje element referues dhe lidhes i qytetit me detin dhe me shetitoren e re.

Ne pjeset anesore te shetitores jane vendosur stola te gjate dhe jane mbjellur peme ne menyre te crregullt te cilat krijojne hije dhe nje ambjent te pershtatshem per te qendruar . Lidhur me disa nderhyrje te tjera te vogla ne rrugen Taulantia si sistemimi i kalimit te kembesoreve i cili lidhet me sheshin dhe kalimit te kembesoreve ne Torren Veneciane, ky element nderton ne menyre te qarte lidhjet me muret antike, me qendren e qytetit dhe ujin duke u bere ne te njejten kohe element kyc i bregdetit. Monumenti ekzistues nuk do te preket por do te qendroje brenda ne park i aksesueshem direkt nga sheshi i hyrjes duke u bere nje skulpture e vendosur ne gjelberim si te tjerat ekzistuese te cilat do te ruhen.



Nje raport i ri me ujin “ te futesh ne det”

Shetitorja pergjate detit vjen lehtesisht e ngritur dhe e hapur drejt ujit me shembjen e murit ekzistues. Nje dizajn unik karakterizon rrugen qe te lejon te afrohesh ne det ne menyre te lire dhe te vazhdueshme. Shtrimi me kubik gjyre gri dhe te bardhe e ben shetitoren menjehere te identifikueshme. Vazhdimi i shetitores nderpritet nga rruget te cilat vijne nga qyteti si dhe nga hapesira me te medha, te pasura nga prezenca e stolave dhe pemeve: “sheshet ne det”. Sheshet shtrihen drejt ujit duke lejuar te arrish pothuajse brenda, duke ripercaktuar plotesisht raportin me ujin. Drejt detit, sheshet do te luajne nje rol te rendesishem si dallge kthyese per zbutjen dhe shuarjen e forces se dallgeve gjate stuhise. Shetitores i bashkohet pergjate detit edhe nje rruge e rendesishme e cila te lejon te ulesh , te hysh ne plazh ose te arrish ne det gjate zbatices. Kater kembe shkalle me lartesi te limituar dhe me largesi te ndryshme zgjidhin diferencen e kuotes midis shetitores dhe reres: kjo krijon mundesine per te ndryshuar rrenjesisht pamjen nga deti; shetitorja e re te afron me detin dhe krijon nje shfrytezim plotesisht te ndryshem nga ai i situates aktuale.

E gjithë rruga është e shoqëruar nga një rresht me pisha dhe nga stola të gjata që të lejojnë të ulesh pranë detit dhe të shetisesh nën hijen e pemëve. E gjithë hapesira e shtruar ekzistuese kompletëhet, rregullohet dhe reduktëhet në favor të parkut: një linjë e lakuar përcakton një hapësirë me dimensione vazhdimisht të ndryshueshme që lidhet me fundin e rruges në det, krijon me shumë hapësirë dhe përcakton lidhjet me parkun. Shtrimi në menyre uniforme dhe me ngjyrë të qartë e të hapur, i moduluar nga vizatimi i vijave të bardha kontribuon në përforsimin e sensit të vazhdimësisë të hapësirës. Shetitorja zgjatet në lindje duke u ngushtuar butesisht dhe duke krijuar kështu një hapësirë për lojëra dhe një parkim të ri. Në të ardhmen rruga mund të vazhdojë në përputhje me rregullat portuale deri tek moli i portit të ri turistikë. Për pjesën perëndimore të projektit që lidhet me pjesën e sistemeve të bera së fundmi përreth “ Sfinksit”, propozohet shtrimi i thjeshtë me pllaka graniti ngjyrë gri, në vazhdimësi me pllakat ekzistuese dhe vendosja e shtyllave të reja të ndricimit, shtreterit e luleve ekzistuese sëbashku me palmat do të ruhen.





Nje park i madh me nje funksion te ri

Hapesira e gjelbere ekzistuese , aktualisht e fragmentur dhe e varfer ne bimesi, sidomos ne peme, do te zgjerohet ne hapesira jeshile me te madha te vazhdueshme dhe te dizenuara mbi parime te reja. Linja e lakuar afron dhe largon gjelberimin nga rruga prane detit dhe ne te njejten kohe krijon hapesira jeshile me permase te ndryshme ne te cilat do te vendosen tipe te ndryshme lojeras per femijet. Te katert hapesirat e krijuara per lojera vendosen ne zonat ne forme eliptike te krijuara nga linja e lakuar e parkut te cilat jane te aksesueshme nepermjet rrugeve dhe shesheve ne park. Shetitja, clodhja dhe relaksi, lojerat dhe aktiviteti fizik me varietete dhe mundesi mjaft te pasura e bejne parkun nje hapesire publike multifunksionale te rendesishme per qytetin, qytetaret e tij dhe turistet qe e vizitojne ate, hapesire qe mungon ne te gjithë zonen qendrore.



Zonat e lojes

Ne brendesi te parkut, ndermjet zones se gjelbert dhe shetitores afer detit jane vendosur hapesira per lojera dhe sport.

Keto zona jane menduar te ndertohen te tilla per zhvillimin e aktiviteteve te ndryshme dhe nga perdorues te ndryshem, duke perfshire aktivitetin fizik dhe relaksin per te rriturit. Lojerat jane grupuar sipas moshes referuar femijeve nga mosha 1 deri ne 15 vjec. Vecanerisht ne zonen 1 jane vendosur lojera per femijet e vegjel nga 2 deri ne 4 vjec dhe per femijet e rritur deri ne 12 vjec, zona 2 do te perdoret nga femijet me moshe nga 8 deri ne 14 vjec por pajisjet e parashikura per lojerat mund te shkembehen pavaresisht moshes dhe ndarjeve ne zona sipas saj.

Lojerat jane zgjedhur duke menduar jo vetem argetimin dhe aktivitetin fizik por edhe socializimin dhe te qendruarit sebashku: paisjet lejojne qe te organizosh sfida ekuilibri dhe shpejtesie, mbi te gjitha ne grupe te vogla.

Zonat 3 dhe 4 jane te pajisura per ushtrime fizike: nje fushe multifunkionale, me shtrim sintetik, kryesisht per te luajtur kalceto dhe basketball, nje fushe ne rere per beach volley dhe per aktivitete te tjera . Nuk behet fjale per hapësira me aktivitete konkurruese po per fusha ku mund te kryhen aktivitete nga njerez te ndryshem qofte dhe ata joprofesionist.

Per dy zonat e para te lojerave eshte zgjedhur nje shtrim me zhavorr per arsye mirembajtje dhe sigurie ndaj goditjes. Behet fjale per nje shtrese zhavorri me spesor minimal 20 deri ne 30 cm poshte paisjeve me granulometri 2 deri ne 8 milimetra pa argjil dhe sedimentete tjera qe siguron sipas normave europiane aktuale absorbimin e goditjeve pa perdour tapete te shtrenjta gome ose te ngjashme. Zhavorri mban te fresket hapësiren e lojerave, vendoset mire midis gjelberimit te parkut dhe shtrimit me beton me inerte te shetitores i cili mud te perdoret me te njejten inerte si betoni. Ne disa nga hapësirat e lojerave jane vendosur disa zona me stola dhe tavolina ku femijet sebashku me te rriturit dhe te moshuarit mund te ulen dhe te qendrojne, te luajne me letra ose domino ose te kontrollojne femijet qe perdorin lojerat e tjera.

Zona per spektakel

Prane "sheshit-mol" eshte vendosur nje hapësire per spektakle dhe evenimente te vogla : kjo hapësire e vecante per nga forma dhe pozicioni nderton nje lloj lidhje ndermjet pjeses ekzistuese te bregdetit dhe pjeses se re nga lindja. Kjo zone eshte nje arene e vogel e krijuar nga nje ulje te lehte e terrenit e cila shfrytezohet afersine me planin e sheshit qe ndodhet me lart dhe krijon mundesi per hapësira vendesh per tu ulur me pjerresi.



Bimesia

Per te krijuar nje peisazh interesante dhe te shumellojshem edhe nga pikepamja e bimesise, parashikohen nje seri e pasur me esenca. Ne vecanti lloje druresh si pisha (Pinus pineaster, Pinus pinea, Pinus halepensis), tamerici (Tamarix gallica), lisi (Quercus ilex, Quercus coccinea, Quercus pubescens), mimoza (Acacia dealbata), Paulownia tomentosa, carrubo (Ceratonia siliqua); shkurre dhe lule si oleandra (Nerium oleander), Ligustra, cisto (Cistus salvifolius), rosmarina (Rosmarinus officinalis), lentisco (Pistacia lentiscus), l'Eleagno (Elaeagnus ebbingei), mirto (Myrtus communis), l'erica (Erica arborea), fillirea (Phillyrea angustifolia); gjelberim me Stipa ne lloje te ndryshme, l'elicrisio (Helichrysum Argyrophyllum), lavanda (Lavandula angustifolia ed altre), l'erica (Erica carnea), lippia

(Lippia nodiflora), teucrium (Teucrium fruticans, Teucrium asiaticum), delosperma (Delosperma cooperi), gazania (Gazania maritima), etj.

Te gjitha llojet e bimesise qe jan te listuara me siper jane te pershtatshme per nje kontekst mesdhetar dhe adaptohen mire me kushtet ne te cilat do te vendosen. Ne vecanti prane pemeve me te madhe dhe qe rriten me ngadale jane vendosur lule me te vogla , me te seleksionuara, per efekt ngjyrash dhe shpejtesie ne zhvillim. Disa pjese ne vecanti neper bordura dhe drejt rruges Taulantia jane trajtuar si kopshte te vertete me ngjyra me perdorimin e tapeteve te barit dhe pemeve te lulezuara.

Tek bimesia me shume rendesi do ti kushtohet kushteve te bimesise me drenazhe te pershtatshme per gropat e pemeve dhe mbeshteteseve per pemet ne baze te terrenit te pasur vegjetal te pershtatshem per rritjen e tyre.

Drita dhe hija, ngjyra dhe aroma qe ndryshojne me nderrimin e stineve, zbutja e ndotjes atmosferike dhe akustike si dhe krijimi i nje strukture te kujdesshme te zonave te gjelbera lejon te ndertohen hapësira interesante dhe te rehatshme, duke permiresuar me kalimin e kohes mireqenien e qytetit ne kompleksitetin e tij.



Zona per evente dhe nje parkim i ri ne sherbim te qendres

Projekti shtrihet deri ne lindje aty ku lidhet edhe me rrugen Taulantia.

E gjithë kjo zone e madhe është strategjike për funksionimin e pjesës qendrore të qytetit dhe vijës bregdetare: parashikohet të realizohet këtu një parkim goxha i madh (afërsisht 170 vende për automjete) dhe një hapësirë në gjendje që të mbajë lojërat të cilat aktualisht janë të vendosura në mënyrë të papërshtatshme përgjatë shetitores, evente okazionale si festa të hapura si dhe tregje javore. Pozicioni i parkimit shërben në mënyrë optimale si për shetitoren edhe për zonën qendrore. Parkimi dhe zona për evente janë të aksesueshëm me makine nepermjet nje rruge pjeserisht te re qe lidhet me rrethrrrotullimin e ri te rruges Taulantia.

Gjithashtu është lehtësisht e aksesueshme edhe në këmbë përmes rruges ekzistuese ndërmjet dy ndërtesave të larta dhe përmes trotuarit të realizuar së fundmi së bashku me rrethrrrotullimin. Parkimi shumë i thjeshtë në disegno dhe në funksionim është imagjinuar si vazhdim i parkut i mbjellur me rreshta me peme, i shtruar me beton drenazhues me ngjyrë dhe zona të gjelbërta që nderhyjnë tek ndërtesat ekzistuese.



MATERIALET

Materialet e propozuara kane si qellim te perforcjne zgjedhjet per te cilat eshte folur deri tani me nje qendrim i cili favorizon materialet e forte, te prodhuar ne vend dhe te pariciklueshem. Nje numer i limitueshem materialesh ne menyre per ta bere me te dukshme nderhyrjen te cilat nuk kane nevojte per mirembajtje.

Pllakat prej guri gri dhe te bardha (cm 15x15) ne perqindje te ndryshme sipas situate te vendosura ne rreshta te drejte karakterizojne shetitoren afer detit dhe disa elemente lidhese terthore. Kombinimi i rastesishem i kubikeve gri dhe te bardhe dhe vendosja ne perqindje te ndryshme te tyre krijon nje efekt kromatik dhe te jep pershtypjen sikur levizin: ne sheshe mbizoteron e bardha, ne zonat lineare mbizoteron grija.

Shtrimi me kubike shtrihet edhe neper sheshe ne te cilat per te perforcuar rolin e polaritetit vendosen kuadrata te medha si tapete te realizuar me gure te bardhe vendas me siperfaqe ne plan te sharruar qe krijon siperfaqe te bute dhe te rregullt. Ne brendesi te ketyre tapeteve te medha vendosen stola dhe peme duke realizuar keshtu sallone te vertete urbane. Hapesirat me te zgjeruara te shetitores se re shtrohen me beton me ngjyre me inerte te perzgjedhura.

Ky lloj materiali i njeiti qe po perdoret per sisteme rreth Torres Veneciane dhe ne pjesen e fillimit te rruges Taulantia shkon me idene e vazhdimesis se hapesires eshte i lehte per tu vendosur, me durueshmeri te larte i cili mund te mbaj nepermjet perdorimit te inerteve te zgjedhur siperfaqe te perfunduara te ndryshme si dhe vendosjen e materialeve te tjere te cilet krijojne efekte estetike. Tonalitetet e qarte te reres deri ne te bardhe percaktojne kushte te ndryshme.

Sheshi – mol ne hyrje te parkut eshte e shtruar me pllaka guri vendase me gjeometri te ndryshme per te karakterizuar pjeset.

Rruga qe te con drejt detit eshte e realizuar me beton te thjeshte ngjyre gri me inerte te qarte dhe kokerr trashe me nje shtrese te vetme ne gjendje per ti rezistuar forcave te dallgeve. Ne shkallare vendoset nje bordure e parafabrikuar me beton ngjyre gri. Hapesira per spektaklet, si sheshet jane te shtruar me gure te bardhe si “opus incertum”.

Nje kujdes i vecante eshte treguar per zgjedhjen e materialeve te shtrimit ne zonen e eventeve dhe parkimit. Hapesirat e medha te shtruara sjellin nje numer te madh problemesh te mjedisit dhe te peisazhit: hidroizolim ne rastin e shirave te medha dhe kanalizime te kushtueshme: mbi nxehe te siperfaqes duke theksuar efektin “ishulli i ngrohur”. Per keto arsye eshte zgjedhur te perdoret beton drenazhues i shoqeruar nga nje nenshtrese me te njejten matrice i cili sherben per te thithur sasira te medha uji. Ky material i vendosur me nje trashesi te caktuar garanton veti shume te mira te rezistences, te lejon te heqesh dore nga kanalizimet per largimin e ujerave dhe nuk le substanca te rrezikshme ne terren. Zgjedhja e nje ngjyre oker te qarte afer tonalitetit te reres ne plazh ben qe ky material i vendosur te duket sa me natyral. Per zonat e lojerave eshte zgjedhur te

perdoret zhavorr kokerr imet me tonalitet te hapur qe absorbon goditjet per shkak te renjes, krijon efekt estetik, freski, eshte ekonomik dhe nuk ka nevojë per shume mirembajtje.

Ne pergjithesi dominojne tonalitet e hapur dhe materialet me kapacitetet te ulet per te absorbuar ngjyrat (albedo) per te ulur nxjehjen e tepert dhe efektin “ ishulli i ngrohur ”.

Propozohet te vleresohet mundesia e perdorimit te materialeve te shtrimit ekzistues qe merren nga prishja e saj ose si materiale per rifiniture ne nderhyrje te tjera (psh si pllakat vetshtrenguese), ose si materiale per nenshtresa: te gjitha materialet inerte te marra prishja e shtrimit ekzistues dhe jo te pershtatshme per rifiniture mund te grimcohen dhe te perdoren si nenshtresa drejteperdrejte si inerte ne beton.

Elementet e arredimit: stolat

Elementet e arredimit , ne vecanti vendet per tu ulur jane menduar si orendi fikse (per shkak te differences se kuotave dhe sistemimeve qe do te realizohen; psh. Bordura e nje aiuole mund te behet nje stol), duke u kujdesur per to dhe duke qene te sigurta , te thjeshta dhe te afta per ti rezistuar kohes (edhe nga akte vandaliste) pa pasur nevojë per mirembajtje. Stolat dhe elementet e tjere arredues duhet te jene objekte qe nuk krijojne veshtiresi ne hapesire por elemente diskrete, funksionale te realizuar me materiale te pershtatshme ne te njejtin tonalitetet me ambjentin ku do vendosen. Te gjitha stolat jane realizuar ne vend si blloqe homogjene te gjate me beton te bardhe me inerte te bardhe te perzgjedhura.

Ndenjeset e stolave ndahen ne baze te pozicionit qe kane keta te fundit: ata te gjatet qe jane te vendosura prane bordurave te shetitores dhe me afer detit, e kane ndenjesen me material guri te bardhe; ato ne brendesi te shesheve i kane ndenjeset prej drurit te larshit.

Ndricimi

Projekti parashikon nje sistem te ri ndricimi per te gjithë ambientin, ne gjendje te transmetoj nje ndjesi te kendshme dhe sigurie pergjate gjithë shetitores.

Propozohen tre tipe ndricuesish me lartesi te ndryshme te ndricimit. .E gjithë shetitorja eshte e karakterizuar nga ndricues me dy pika ndricimi me lartesi te ndryshme 6m dhe 4 m nga ana e detit.Ne sheshe propozohet nje trup ndricuesi me lartesi (3.60 m) me nje dizain te vecante ne menyre qe te evidentoj keto sheshe si naten ashtu edhe ditën.

Per hapesiart ne zonat e lojrave dhe ne zonate eparkimeve propozohen trupa ndricuesish me lartesi 7 m .

Te gjithë ndricimet me eficence te madhe nuk japin ndricim nga lart,kane burim ndricimi LED me shkalle sigurie min IP66. Per LED eshte zgjedhur nje temperature ngjyre te ngrohte (3000K) per te evituar ndricim shume te bardhe dhe jo natyrale qe mund te shqetesojne shikimin. Impianti eshte programuar dhe e kontrollueshme per fikjen dhe gradimin per gjate oreve te ndryshme te nates.

Stafi qe kerkohet per realizimin e objektit.

Projekti per rehabilitimin e shetitores Taulantia te qytetit te Duresit parashikon te kete :

- Nje park i madh me nje funksion te ri.
- Ndertimi i “Zones per spektakel”
- Ndertimi i nje “Sheshi mol”
- Rruga qe te con drejt detit
- Ndertimi i Zones se lojes
- Ndertimi i zones per evente dhe nje parkim i ri ne sherbim te qendres.
- Arredimit urban.
- Sistemi i ri ndricimi per te gjithë ambientin.

Stafi qe eshte i nevojshem per realizimin e punimeve :

- Inxbinier ndertimi, minimumi 1 (nje)
- Arkitekt/Urbanist, minimumi 1 (nje)
- Inxbinier hidroteknik, minimumi 1 (nje)
- Inxbinier elektrik, minimumi 1 (nje)
- Inxbinier topograf, minimumi 1 (nje)
- Inxbinier mjedisi, minimumi 1 (nje)
- Inxbinier kimist, minimumi 1 (nje)

